

VENDIM
Nr. 678, datë 11.9.2026

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR PAVLEFSHMËRINË E KONTRATAVE TË KONCESIONEVE DHE PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 72, të ligjit nr. 88/2025, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni i Prokurimit Publik është organi kompetent për shqyrtimin e ankesave për pavlefshmërinë e kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik privat.

2. Operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesë për shqyrtimin e pavlefshmërisë së kontratës te Komisioni i Prokurimit Publik. Në çdo rast, kjo ankesë duhet të paraqitet brenda 6 (gjashtë) muajve nga e nesërmja e datës së lidhjes së kontratës.

3. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës, me vendim të ndërmjetëm, vendos pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të kontratës deri në marrjen e një vendimi përfundimtar. Komisioni i Prokurimit Publik mund të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë zbatimin e kontratës, nëse pezullimi mund të cenojë çështjet thelbësore të interesit të përgjithshëm.

4. Komisioni i Prokurimit Publik mund të shpallë një kontratë absolutisht të pavlefshme, kur konstaton ekzistencën e kushteve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 72, të ligjit nr. 88/2025, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

5. Nëse pas shqyrtimit të të gjitha aspekteve përkatëse, Komisioni i Prokurimit Publik çmon se shpallja e pavlefshmërisë absolute të kontratës mund të cenojë çështjet thelbësore të interesit të përgjithshëm, vendos të mos e shpallë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Për mosshpalljen absolutisht të pavlefshme të kontratës nuk konsiderohen çështje thelbësore të interesit të përgjithshëm interesat ekonomikë, të lidhur drejtpërdrejt me kontratën në fjalë, si:

a) kostot për shkak të vonesave në zbatimin e kontratës;
b) kostot për shkak të shpalljes së një procedure të re koncesioni apo partneriteti publik privat;

c) kostot për shkak të ndryshimit të operatorit ekonomik, që do të zbatojë kontratën;

ç) kostot për shkak të detyrimeve ligjore si pasojë e pavlefshmërisë.

6. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, në rastin kur nuk shpallet pavlefshmëria e kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik vendos:

a) të shkurtojë afatin e zbatimit të kontratës;

b) dënimin me gjobë të autoritetit ose entit kontraktor për shkeljet e konstatuara, sipas këtij vendimi.

¹ Ky vendim përafrohet plotësisht me:

- direktivën 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989, “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative, në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, me numër CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 395, datë 30.12.1989, faqe 33–35;

- direktivën e Këshillit 92/13/KEE, datë 25 shkurt 1992, “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative, në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit për procedurat e prokurimit të enteve, që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit”, me CELEX 31992L0013, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 76, datë 23.3.1992, faqe 14–20.

7. Gjoba vendoset në raport me vlerën e kontratës së nënshkruar, por, në çdo rast, jo më shumë se 10% e kësaj vlere.

8. Në vendosjen e masës së gjobës, Komisioni i Prokurimit Publik duhet të marrë në konsideratë disa elemente, si:

- a) rrethanat në të cilat është kryer shkelja;
- b) rëndësinë e shkeljes së kryer;
- c) pasojat që kanë ardhur;
- ç) proporcionalitetin midis dëmit të shkaktuar dhe masës së gjobës;
- d) vlerën e përlllogaritur të kontratës;
- dh) parimet e koncesionit dhe partneritetit publik privat që janë shkelur;
- e) përsëritjen e shkeljeve në raste të tjera.

9. Komisioni i Prokurimit Publik në vendim përcakton edhe afatin, brenda të cilit ky vendim duhet zbatuar.

10. Palët kanë të drejtë të ankimojnë vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik në gjykatën përkatëse, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative, sipas përcaktimit në nenin 66, të ligjit nr. 88/2025, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

11. Ngarkohet Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 88/2025, “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”.

KRYEMINISTËR
Edi Rama